

VENDIM
Nr. 823, datë 26.11.2014

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQEVE PYJORE NË
EKONOMINË PYJORE “DRIN-GJADËR-KIR”, NË QARKUN E SHKODRËS, PËR
NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT TË ASHTËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 98.62 (nëntëdhjetë e tetë pikë gjashtëdhjetë e dy) ha në ngastrat pyjore 4, 10, 11, 12, 13, 14, të ekonomisë pyjore “Drin-Gjadër-Kir”, pjesë e Fondit Pyjor Publik në Qarkun e Shkodrës, që do të përdoret për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentralit të Ashtës, hiqet nga Fondi Pyjor Publik dhe çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Të dhënat për ngastrat pyjore dhe sipërfaqet e tyre jepen në tabelën 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Sipërfaqet pyjore sipas pikës 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në funksion të lidhjes së marrëveshjes me shoqërinë “Energji Ashta” sh.p.k.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, bëhen ndryshimet përkatëse në regjistrin e Kadastrës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

4. Vlerat përkatëse të pakësimit në volum të lëndës drusore dhe produkteve të tjera pyjore, sipërfaqet dhe investimet e kryera në vite në pyje, objekt i këtij vendimi, paguhen nga shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k., në bazë të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k., brenda 5 (pesë) viteve, duhet të pyllëzojë me fondet e saj 295.86 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e gjashtë) ha, sipërfaqe me drurë pyjorë në ekonominë pyjore të përcaktuara në marrëveshjen e lidhur ndërmjet shoqërisë “Energji Ashta”, sh.p.k., dhe Ministrisë së Mjedisit.

6. Ministria e Mjedisit dhe shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k., nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët për hapat, afatet dhe procedurat për hartimin e projekteve teknike të heqjes së materialit drusor.

7. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E NGASTRAVE DHE NEN NGASTRAVE QE DO TE HIQEN
NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALIT TË ASHTËS, në Komunën BUSHAT

QARKU SHKODËR

Lidhja 1

<i>ID Prones</i>	<i>Ekon.Pyjore/Kullosore</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe hiqen nga fondi pyjor(ha)</i>
Sh22 0004	Drin-Gjader-Kir	4	Komuna Bushat	65.68
Sh22 0010	Drin-Gjader-Kir	10	Komuna Bushat	17.95
Sh22 0011	Drin-Gjader-Kir	11	Komuna Bushat	8.16
Sh22 0012	Drin-Gjader-Kir	12	Komuna Bushat	5.98
Sh22 0013	Drin-Gjader-Kir	13	Komuna Bushat	0.36
Sh22 0014	Drin-Gjader-Kir	14	Komuna Bushat	0.49
GJITHSEJ				98.62